TË DHËNAT TEKNIKE

ZEUS-AL

Bojra & Verniqe

SUPERLUX

BOJË AKRILIKE PËR PËRDORIM
TË JASHTËM & BRENDSHËM

PËRSHKRIMI TEKNIK

SUPERLUX është një bojë me bazë uji me cilësi të lartë , e cila bazohet në rezina speciale te tipit kopolimer akrelik.Ka një performance shumë te mirë dhe është rezistent ndaj larjes, gërvishtjeve, dhe për më tepër ofron mbrojtje të shkëlqyer ndaj rrezeve ultra-violet dhe kushteve atmosferike. Duke qenë se ka një përqindje të ulët arome, ajo është e përshtatshme për t'u përdorur në amb-jente të brendshme. Boja nuk përbën rrezik për përdoruesin apo mjedisin. Nuk ka përmbatje metali. Eshtë e disponueshme në ngjyrë të bardhë dhe në një shumëllojshmëri ngjyrash të përgatitura përmes sistemit të ngjyrave **ZEUS-AL**. Eshtë e përshtatshme për përdorim të jashtëm dhe të brendshëm.

CILËSITË

Karakterizohet nga një mbulueshmëri shumë e mirë, dhe është resistente ndaj pastrimit. Mund të lahet lehtë me ujë duke qenë se nuk dëmtohet nga detergjentët. Aplikohet lehtë, nuk mban erë dhe është rezistente ndaj zverdhjes. Ka bardhësi perfekte.
Produkti mund të aplikohet shumë lehtë me furçë, rul ose pistoletë.

FUSHA E APLIKIMIT

Përdoret për dekorimin e sipërfaqeve të brendshme ose të jashtme, të cilat janë me suva, allçi, stuko, beton, dru, etj, veçanërisht në vendet ku kemi nevojë për mbrojtje ndaj rrezeve ultra-violet dhe kushteve atmosferike.

VOC (Përbërësit e Paqëndrueshëm Organik)
Vlera limit e BE: për këtë kategori produkti A/a (Bojra për mure dhe ambjente te jashtme me natyrë minerale) : 75g /l (2007) dhe 40g /l (2010).
Ky produkt përmban maksimalisht 10 g/l VOC.

ZEUS - AL Adresa: L.14, Rr. "Asti Gogoli", ish NPA, Shkozet - Durrës
Tel: +355 52 265 461 / E-mail: info@zeus-al.com
web: www.zeus-al.com

SUPERLUX

BOJË AKRILIKE PËR PËRDORIM TË JASHTËM & BRENDSHËM

APLIKIMI

Sipërfaqja që dëshirojmë të lyejmë duhet të jetë e pastër,e thatë, pa praninë e shtresave të vjetra të bojës, vajrave, yndyrnave, kripërave, etj. Sipërfaqet e dëmtuara duhet të stukohen më parë me SPECIAL STUCCO të **ZEUS – AL**.Sipërfaqet e reja ose sipërfaqet poroze të lyera me gëlqere ose me bojë të cilësisë së dobët, në fillim duhet të trajtohen me një dorë astar LATEX të **ZEUS – AL**, të holluar deri në masën 300% - 400% me ujë dhe pas tharjes të aplikohen dy duar me **SUPER-LUX**. Për një rifreskim të sipërfaqeve të lyera me bojë, aplikoni direkt dy duar me **SUPERLUX**. Për të rritur efikasitetin në sipërfaqet e lyera më parë me bojë, rekomandohet që në fillim të aplikohet një dorë me astar FIXDUR të **ZEUS – AL**, të holluar deri në masën 100% me BRUSH SOLVENT No100.

Hollimi për furçë ose rul: 5-10% me ujë sipas peshës.
Hollimi për pistoletë: 5-10% me ujë sipas peshës.
Aplikimi: Aplikoni 1-2 shtresa mbi sipërfaqen e pastruar dhe të përgatitur mirë.
Temperatura e aplikimit: 5 deri në 35°C.

TË DHËNA TEKNIKE

Ngjyra: E bardhë & ngjyrë
Rezina: Kopolimer akrilik
Densiteti (e bardhë): 1.50±0.01 gr/ml (EN ISO 2811.01-02, 20°C)
Viskoziteti i produktit në prodhim: 103±5 KU (ASTM D 562-05, 25°C)
Viskoziteti i produktit në magazinim: 110±10 KU (ASTM D 562-05, 25°C)
Substanca të ngurta sipas peshës (e bardhë): 62±1% (EN ISO 3251-03)
Substanca të ngurta sipas vëllimit (e bardhë): 76±1% (ISO 3233-98)
pH: 8.5-9.0 (ISO 976-96)
Temperatura minimale e formimit të filmit: 0°C (ASTM D 2354)
Qëndrueshmëria në paketim: 9/10 (1 muaj, 50°C) (ASTM D 1849-03)
Shkëlqimi, në 85°: 5±2 (ELOT EN ISO 2813-99)
Koha e tharjes në 25° C:

- Tharja në sipërfaqe: 20-40 min
- Tharja ne brëndësi: 45-60 orë
- Rilyerja: pas 1-2 orë

Pika e ndezjes: n.a. (ELOT EN ISO 1523-02)
Ngjitja në çimento(ndër-prerë): 0 (ELOT EN ISO 2409-95)
Mbulimi : 10 – 11 m²/lit për shtresë në sipërfaqet e përgatitura mirë.

Shënim:

- Rekomandohet që sipërfaqet e lyera të lahen 20-30 ditë pas aplikimit të bojës, në rast se është e nevojshme.
- Mbi sipërfaqe me suvatim të freskët, rekomandohet që produkti të aplikohet të pakën 30-40 ditë më pas.
- Rekomandohet shmangia e përdorimit të produktit në temperatura nën 0°C ose pak para shiut.

ZEUS - AL Adresa: L.14, Rr. "Asti Gogoli", ish NPA, Shkozet - Durrës
Tel: +355 52 265 461 / E-mail: info@zeus-al.com
web: www.zeus-al.com